

ISSN 1857-8640
ISSN 1857-9396

UDC 3(497.7:4-672 EU)

CENTRUM

5

 **QMBI**

- Centrum No. 1 - 2013
- Centrum No. 2 - 2014
- Centrum No. 3 - 2015
- Centrum No. 4 - 2015
- Centrum No. 5 - 2016
- Centrum No. 6 - 2016
- Centrum No. 7 - 2017
- Centrum No. 8 - 2017
- Centrum No. 9 - 2018
- Centrum No. 10 - 2018
- Centrum No. 11 - 2019
- Centrum No. 12 - 2019
- Centrum No. 13 - 2020
- Centrum No. 14 - 2020



International Editorial Board

Herbert Küpper, PhD

Institute of East Law, Munich, Germany

Michael Privot, PhD

University of Liège, Belgium

Murat Ali Karavelioğlu, PhD

Istanbul University, Turkey

Talat Islam, PhD

University of the Punjab, Pakistan

Christo Ananth, PhD

Francis Xavier Engineering College, India

Lana Milivojevic, PhD

University of Zagreb, Croatia

Metodi Shamov, PhD

Sofia University St. Kliment Ohridski, Bulgaria

Altin Shegani, PhD

University of Tirana, Albania

Vehbi Hoti, PhD

University of Shkodra, Albania

Regjina Gokaj, PhD

University of Tirana, Albania

Ahmet Alibašić, PhD

University of Sarajevo, Bosnia and Herzegovina

Munir Drkić, PhD

University of Sarajevo, Bosnia and Herzegovina

Milazim Krasniqi, PhD

University of Prishtina, Kosovo

Hysen Matoshi, PhD

University of Prishtina, Kosovo

Edmond Beqiri, PhD

University Haxhi Zeka, Kosovo

Vlado Kambovski, PhD – academician

Academy of Sciences and Arts of the Republic of North Macedonia

Ferid Muhiq, PhD

St. Cyril and Methodius University of Skopje, North Macedonia

Nazmi Maliqi, PhD

First Private University FON, North Macedonia

Abstracting & Indexing

1. National and University Library "St. Clement of Ohrid" - Skopje

ISSN: 1857-8640 (printed version)

ISSN: 1857-9396 (online version)

UDC: 3 (497.74-672EU)

2. Google Scholar

3. RootIndexing

4. ROOT IMPACT FACTOR: 1.127

5. GLOBAL IMPACT FACTOR: 0.398

6. ISI Impact Factor 1.919

7. University Journals

8. ICI World of Journals Copernicus

Përmbajtja/Sодржина/Content

Mr.sc. Ahmet IMAMI	
REFORMAT NË SISTEMIN PROKURORIAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS	9
РЕФОРМИТЕ ВО ОБВИНИТЕЛСКИОТ СИСТЕМ НА РЕПУБЛИКА КОСОВО	9
REFORMS OF THE PROSECUTORIAL SYSTEM IN KOSOVO	9
Aleksandar KITANOVSKI, PhD	
Prof. Aleksandar DONCEV, PhD	
IMIGRIMI ILEGAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË	22
ИЛЕГАЛНА ИМИГРАЦИЈА ВО РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА	22
ILLEGAL IMMIGRATION IN REPUBLIC OF MACEDONIA	22
M-p Марија Вељовска Кондовска	
Проф. Д-р Александар Дончев	
Доц. Д-р Александар Китановски	
SFIDAT E SIGURISË DHE KRIZA ME MIGRANTËT NË UNIONIN EVROPIAN.....	34
БЕЗБЕДНОСНИТЕ ПРЕДИЗВИЦИ И МИГРАНТСКАТА КРИЗА ВО	
ЕВРОПСКАТА УНИЈА	34
SECURITY CHALLENGES AND MIGRANT CRISIS IN THE EUROPEAN UNION	34
M-r Amir Dalipi	
Doc. d-r Naser Etemi	
ZBATIMI I PROGRAMIT ANTIKORRUPSION NGA SEKTORI I KONTROLLIT	
TË BRENDSHËM DHE STANDARDEVE PROFESIONALE	49
ПРИМЕНА НА АНТИКОРУПЦИСКА ПРОГРАМА НА СЕКТОРОТ ЗА ВНАТРЕШНА	
КОНТРОЛА И ПРОФЕСИОНАЛНИ СТАНДАРДИ	49
APPLICATION OF ANTI-CORRUPTION PROGRAM BY SECTOR FOR INTERNAL	
CONTROL AND PROFESSIONAL STANDARDS	49
Анета Атанасовска	
AUTORIZIMI NË КОНËН E DOMINATIT	58
ПОЛНОМОШНОТО (MANDATUM) ВО ВРЕМЕТО НА ДОМИНАТОТ	58
MANDATE (mandatum) IN THE PERIOD OF DOMINATE	58
Arlinda Kadri-Shahinoviq	
TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E PALËVE NË MARTESË ME ELEMENT	
NDËRKOMBËTAR	77
ПРАВА И ОБВРСКИ НА СТРАНИТЕ ВО БРАКОТ СО МЕЃУНАРОДЕН ЕЛЕМЕНТ	77
RIGHTS AND OBLIGATION OF PARTIES IN MARRIAGE WITH	
INTERNATIONAL ELEMENT	77

CENTRUM 5

MSc. Atifete Thaqi MSc.Shpresa Feraj MSc.Xheladin Gashi	
RËNDËSIA E SHPËRBLIMIT TË PUNONJËSVE NË NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME NË KOSOVË	94
ВАЖНОСТА НА НАГРАДУВАЊЕТО НА ВРАБОТЕНИТЕ ВО МАЛИТЕ И СРЕДНИТЕ ПРЕТПРИЈАТИЈА ВО КОСОВО	94
THE IMPORTANCE OF REMUNERATION OF EMPLOYEES IN SMALL AND MEDIUM ENTERPRISES IN KOSOVO	94
 Prof. dr. Bashkim SELMANI	
SISTEMI PROCEDURAL DHE PROCESI JURIDIKO-CIVIL I PALËVE NË PROCESET GJYQËSORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË	107
ПРОЦЕСНИОТ СИСТЕМ И ГРАЃАНСКО-ПРАВНИОТ ПРОЦЕС НА СТРАНКИТЕ ВО СУДСКИТЕ ПОСТАПКИ ВО РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА	107
PROCEDURAL SYSTEM AND CIVIL JUSTICE PROCESS OF PARTIES IN THE PROCEEDINGS IN THE REPUBLIC OF MACEDONIA.....	107
 Bujar Adili, MA	
DISA PARIME THEMELORE TË ARSIMIT INTERKULTUROR.....	134
НЕКОИ ОСНОВНИ НАЧЕЛА ИНТЕРКУЛТУРНОТО ОБРАЗОВАНИЕ	134
SOME BASIC PRINCIPLES OF THE INTERCULTURAL EDUCATION.....	134
 Donjeta Morina, MSc	
SHKAQET DHE PASOJAT E PËRFSHIRJËS SË FËMIJËVE NË TREGUN E PUNËS - RASTI I KOSOVËS.....	143
ПРИЧИНИТЕ И ПОСЛЕДИЦИТЕ НА ВКЛУЧУВАЊЕТО НА ДЕЦАТА ВО ПАЗАРОТ НА ТРУДОТ – СЛУЧАЈОТ НА КОСОВО	143
CAUSES AND CONSEQUENCES OF THE INVOLVEMENT OF CHILDREN IN THE LABOR MARKET - THE CASE OF KOSOVO	143
 Doc. dr Dragana Randelović Msc. Lemane Mustafa	
ARTI I TË SHKRUARIT SHKURTËR NË PROCEDURAT GJYQËSORE	165
УМЕТНОСТА НА КРАТКО ПИШУВАЊЕ ВО СУДСКИТЕ ПОСТАПКИ	165
THE ART OF BRIEF WRITING FOR LITIGATION	165
 Driton Islami	
MASAT OPERATIVO-TAKTIKE KRIMINALISTIKE DHE VEPRIMET NETIMORE PËR ZBULIMIN E KRIMINALITETIT SEKSUAL.....	180
ОПЕРАТИВНО-ТАКТИЧКИ КРИМИНАЛИСТИЧКИ МЕРКИ И ИСТРАЖНИТЕ ПОСТАПКИ ВО ОТКРИВАЊЕ НА СЕКСУАЛНИОТ КРИМИНАЛ	180
PROVISIONS OPERATIVO- TACTICAL FORENSIC AND INVESTIGATIVE ACTIONS RECOVERY SEXUAL CRIME	180

CENTRUM 5

Elizabeta Spiroska M.Sc.

Ivan Bimbilovski, Ph.D.

NDËMJETËSIMI LEHTËSUES DHE EVALUATIV NË TË DREJTËN CIVILE	202
ОЛЕШУВАЧКА И ЕВАЛУАТИВНА МЕДИЈАЦИЈА ВО ГРАЃАНСКОТО ПРАВО	202
FACILITATIVE AND EVALUATIVE MEDIATION IN CIVIL LAW	202

Esat Elezi

АСПЕКТЕТ Е МЕНАХИМИТ CIVIL МЕ КРИЗАТ BRENDA BE	223
АСПЕКТИ НА ЦИВИЛНОТО МЕНАЦИРАЊЕ СО КРИЗИ ВО РАМКИТЕ НА ЕУ	223
ASPECTS OF THE CIVIL CRISIS MANAGEMENT WITHIN THE EU	223

Fisnik Morina, MSc

PËRSHTATSHMËRIA E POLITIKAVE KREDITORE TË BANKAVE KOMERCIALE NË RAPORT ME PERFORMANCEN E NVM-VE NË KOSOVË	235
ПРИЛАГОДНОСТА НА КРЕДИТОРНИТЕ ПОЛИТИКИ НА КОМЕРЦИЈАЛНИТЕ БАНКИ ВО ОДНОС НА ПЕРФОРМАНСАТА НА МСП ВО КОСОВО.....	235
APPROPRIATENESS OF CREDIT POLICIES OF COMMERCIAL BANKS IN RELATION TO THE PERFORMANCE OF SMEs IN KOSOVO.....	235

Fisnik Sadiku, MA

Besnik Lokaj, MA

Shpend Zogaj, MA (can.)

NDIKIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE NË RRITJEN E TERRORIZMIT BASHKËKONOR.....	258
ВЛИЈАНИЕТО НА ИНФОРМАТИЧКАТА ТЕХНОЛОГИЈА ВО РАСТОТ НА СОВРЕМЕНИОТ ТЕРОРИЗАМ	258
THE IMPACT OF INFORMATION TECHNOLOGY IN THE GROWTH OF CONTEMPORARY TERRORISM	258

Gëzim Xhambazi

REORGANIZIMI FAMILJAR I NDIHMËS SOCIALE – BARAZIA GJINORE	270
СЕМЕЈНА РЕОРГАНИЗАЦИЈА ЗА СОЦИЈАЛНА ПОМОШ - РОДОВА ЕДНАКВОСТ	270
FAMILY REORGANIZATION FOR A SOCIAL WELFARE - GENDER EQUALITY	270

Mr. Kujtim Kasami

SFIDAT E DEMOKRACISË LIBERALE	278
ПРЕДИЗВИЦИТА НА ЛИБЕРАЛНАТА ДЕМОКРАТИЈА.....	278
CHALLENGES OF LIBERAL DEMOCRACY	278

Mersel Bilalli

РЕЖИМЕТ Е ДЕТИТ NË TË DREJTËN NDËРКОМБËТАРЕ	286
РЕЖИМИТЕ НА МОРЕТО ВО МЕЃУНАРОДНОТО ПРАВО	286
THE SEA REGIME IN THE INTERNATIONAL LAW	286

CENTRUM 5

Doc.dr. Mevledin MUSTAFI	
SIGURIA PUBLIKE DHE FUNKSIONET E SË DREJTËS PENALE NË MBROJTJE TË SHOQËRISË BASHKËKOHORE	298
JAVHATA БЕЗБЕДНОСТ И ФУНКЦИИТЕ НА КАЗНЕНОТО ПРАВО ВО ОДБРАНА НА СОВРЕМЕНОТО ОПШТЕСТВО	298
PUBLIC SECURITY AND THE FUNCTIONS OF THE CRIMINAL LAW IN DEFENDING THE COTEMPORARY SOCIETY	298
Murat M. ALIU	
NJË ANALIZË LIBRIT "MBI POLITIKËN" TË AUTORES CHANTAL MOUFFE	311
АНАЛИЗА НА КНИГАТА "ЗА ПОЛИТИКАТА" ОД АВТОРОТ ШАНТАЛ МУФЕ	311
AN ANALYSIS OF THE BOOK "ON THE POLITICAL" OF THE AUTHOR CHANTAL MOUFFE	311
Neritan Turkeshi PhD	
Ajsel Jakupi, MA	
ROLI I MARKETINGUT NDAJ TURIZMIT	324
УЛОГАТА НА МАРКЕТИНГОТ ВРЗ ТУРИЗМОТ	324
THE ROLE OF MARKETING ON TOURISM	324
д-р Никола Мицковски	
д-р Ристо Речкоски	
BAZAT NORMATIVE TË ЕКСПЕРТИЗËS NË PROCEDURËN PENALE NË SHETETET E BASHKUARA TË AMERIKËS.....	337
НОРМАТИВНИ ОСНОВИ НА ВЕШТАЧЕЊЕТО ВО КРИВИЧНАТА ПОСТАПКА НА СОЕДИНЕТИТЕ АМЕРИКАНСКИ ДРЖАВИ.....	337
LEGAL BASES OF EXPERTISE IN THE CRIMINAL PROCEDURE IN THE UNITED STATES OF AMERICA.....	337
Qazime Sherifi	
ANGAZHIMI DIPLOMATIK I SHBA NË KONLIKТИN NDËRETNIK NË ВЕН.....	353
ДИПЛОМАТСКИОТ АНГАЖМАН НА САД ВО МЕЃУЕТНИЧКИОТ КОНФЛИКТ ВО БИХ	353
THE US DIPLOMATIC ENGAGEMENT IN INTERETHNIC CONFLICT OVER BH	353
MSc. Skender Mustafi	
MARKETINGU ISLAM: NË MES TË DEFINUARIT, TË KUPTUARIT DHE TË APLIKUARIT	365
ИСЛАМСКИ МАРКЕТИНГ: МЕЃУ ДЕФИНИРАЊЕТО, РАЗБИРАЊЕТО И ПРИМЕНАТА.....	365
ISLAMIC MARKETING: BETWEEN DEFINING, UNDERSTANDING AND APPLYING	365

37:316.723-021.463

Bujar Adili, MA¹

DISA PARIME THEMELORE TË ARSIMIT INTERKULTUROR

НЕКОИ ОСНОВНИ НАЧЕЛА ИНТЕРКУЛТУРНОТО ОБРАЗОВАНИЕ

SOME BASIC PRINCIPLES OF THE INTERCULTURAL EDUCATION

Abstrakt

Në shoqërinë e sotme çdo fëmijë duhet të jetë i edukuar mirë që të përfshihet në komunitet dhe të jetë i arsimuar për t'i kontribuar shoqërisë dhe komunitetit që do të thotë të jetë i dobishëm për vete dhe individët përreth. Që të arrihet ky nivel është me rëndësi që të gjithë anëtarët e një shoqërie të caktuar të edukohen dhe arsimohen në atë mënyrë që të bëhen të vetëdijshëm për diversitetin e botës që i rrethon dhe në kuadër të kësaj edhe njerëzit që jetojnë në afërsi të tyre dhe të jenë të aftë për t'i respektuar dhe pranuar dallimet. Prandaj nuk mundet më të flitet për edukim dhe arsimim në korniza të një kulture, të një bashkësie të mbyllur, por patjetër të merret parasysh veprimi dhe ndërthurja reciproke e disa bashkësive dhe kulturave të ndryshme dhe po ashtu edhe edukimi dhe arsimi të cilët, në këtë rast, duhet patjetër të jenë interkulturore.

Fjalë kyçe: nxënës, arsim, interkulturë, diversitet

SOME BASIC PRINCIPLES OF INTERCULTURAL EDUCATION

Abstract

In today's society, every child should be educated to be involved in the community and be educated to contribute to society and the

¹ Magjistër i pedagogjisë, e-mail: bujaradili74@gmail.com

community which means to be useful to himself and surrounding individuals. To achieve this level it is important in order that all members of a given society should be educated in such a way that they become aware of the diversity of the world around them and within this the people who live near them and be able to respect and accept differences. Therefore can no longer talk about education into the framework of a culture, a closed community, but necessarily taken into consideration the action and reciprocal interplay of several communities and cultures, and also the education proces which, in this case, must be intercultural.

Keywords: student, education, interculture, diversity

HYRJE

Në shoqërinë e sotme nënkuptohet që edukimi dhe arsimi i ofrojnë një spektër të gjerë të një kulture të përgjithshme, sjellje të mirë dhe manire çdo fëmije që ka privilegjin të jetë i edukuar dhe arsimuar në mënyrë të përshtatshme. Çdo fëmijë duhet të jetë i edukuar mirë që të përfshihet në shoqërinë e tij dhe në komunitet dhe të jetë i arsimuar që asaj shoqërie dhe atij komuniteti në ndonjë mënyrë t'i kontribuojë që do të thotë të jetë i dobishëm për vete dhe individët përreth. Në një situatë në të cilën individët veprojnë bashkë për të krijuar një tërësi funksionale, fokusi tashmë nuk është mbi veprimet konkrete dhe aftësitë të cilat ata individë i posedojnë, mbi mënyrën se si kontribuojnë për shoqërinë e tyre, por ky fokus zgjerohet edhe në marrëdhëniet ndërnjerëzore të cilat po ashtu duhet të jenë në një nivel funksional. Që të arrihet ky nivel është me rëndësi që të gjithë anëtarët e një shoqërie të caktuar të edukohen dhe arsimohen në atë mënyrë që të bëhen të vetëdijshëm për diversitetin e botës që i rrethon dhe në kuadër të kësaj edhe njerëzit që jetojnë në afërsi të tyre dhe të jenë të aftë për t'i respektuar dhe pranuar dallimet. Prandaj nuk mundet më të flitet për edukim dhe arsimim në korniza të një kulture, të një bashkësie të mbyllur, por patjetër të merret parasysh veprimi dhe ndërthurja reciproke e disa bashkësive dhe kulturave të ndryshme dhe po ashtu edhe edukimi dhe arsimi të cilët, në këtë rast, duhet patjetër të jenë interkulturor (Banks, 1999). Në botën bashkëkohore, shumë keqkuptime dhe joto-lerancë dalin nga shumë bashkësi etnike, dallime nacionale dhe religjioze si në kuadër të një kombi ashtu dhe ndërmjet kombeve të

ndryshme.² Në këtë rast arsimit e ka patjetër që individin ta bëjë të ndërgjegjshëm për këta fërkime për të zhvilluar ndonjë farë ideje mbi atë se prej ku buron kjo dhe pse individi dhe grupi tjetër i sheh gjërat aq ndryshe. Prandaj është shumë me rëndësi pyetja se cilët janë ata qëllime të edukimit dhe arsimit interkulturore dhe cilat dije, qëndrime dhe shkathtësi duhet t'i posedojnë individët që me efikasitet të funksionojnë në komunitetet e tyre kulturore por dhe jashtë kornizave të tyre. Po ashtu është shumë me rëndësi se në ç'mënyrë këta dije, qëndrime dhe shkathtësi mund të stimulohen në klasë.

ARSIMIT INTERKULTUROR

Interkultura/multikultura është fenomen botëror e cila në veçanti me globalizimin vjen në shprehje të plotë. Atë që nxiti globalizimi është përparimi i mjeteve të komunikimit të cilat tani mundësojnë një mënyrë konstante dhe pa pengesa të përafërimit kulturave të ndryshme, popujve, njerëzve në përgjithësi, ndërsa nevoja për multikulturalizëm³ sot është aq e fuqishme në botë.

Arsimi interkulturore është proces i cili nga secili prej nesh kërkon të njohim veten dhe kulturën tonë që të jemi të aftë t'i kuptojmë kulturat e të tjerëve. Ky proces është mjaftë sfidues dhe përfshin një punë të bindjes thellë të rrënjës se çka është mirë e çka keq, rishikim të pikëpamjes individuale mbi botën dhe jetën personale. Tërë atë që e marrim si të "mirëqenë", në të mësuarit interkulturore vihet "nën llupë" dhe shqyrtohet në mënyrë kritike. Meqë arsimit interkulturore është proces në të cilin mësojmë se si të jetojmë bashkë në botën e diversiteteve, kjo dhe është pikënisja për ndërtimin e jetës së përbashkët dhe paqes (Geertz, 1999).

Sipas shumë autorëve, arsimit interkulturore është ai që:

Respekton dhe promovon diversitetin në të gjitha fushat e jetës së njeriut. Kjo na bën të ndjeshëm ndaj idesë se njerëzit natyrshëm kanë zhvilluar mënyra të ndryshme të jetesës, zakone dhe pikëpamje mbi botën dhe se kjo shumëllojshmëri e jetesës njerëzore të gjithëve na pasuron.

² Borbély N. É., *Innovative Educational Initiatives in Nagykanizsa*. Online në: <http://lgi.osi.hu/ethnic/csdb/results.asp?idx=no&id=37>. [02.03.2016,23:01h]

³ Haller, I.; Ardelean, L., *MulticulturalAcademy in Romania*. LGI Case Studies Database. Online në: <http://lgi.osi.hu/ethnic/csdb/results.asp?idx=no&id=148>. [02.04.2016,16:18h]

Promovon barazi dhe të drejta njerëzore, siguron mundësi të barabarta për të gjithë, i kundërvihet padrejtësisë dhe diskriminimit dhe mëton në vlera mbi të cilat ndërtohet barazia.

Shikuar tradicionalisht, mund të dallojmë dy qasje ndaj arsimit:

1. Arsim multikulturor është ai i cili nëpërmjet të mësuarit për kulturat tjera insiston të mundësojë pranimin apo së paku tolerimin e kulturave të tjera. Termi “multikulturë” përshkruan diversitetin kulturor të shoqërisë (Banks, 1992). Ai nuk u referohet vetëm elementeve të kulturës etnike apo nacionale por përfshin dhe diversitetin gjuhësor, religjioz dhe socioekonomik. Multikulturalizmi vë në pah faktin që njerëz me kultura të ndryshme jetojnë pranë njëri-tjetrit.

2. Arsimi interkulturor mëton të tejkalojë koekzistencën pasive dhe të realizojë një mënyrë të zhvilluar dhe të qëndrueshme të jetës së përbashkët në një shoqëri multikulturore. Kjo bëhet nëpërmjet ndërtimit të mirëkuptimit, respektit reciprok dhe dialogut ndërmjet grupeve me kultura të ndryshme, përmes sigurimit të mundësive të barabarta dhe luftës kundër diskriminimit. Termi “interkulturë” është dinamik dhe i referohet etablimit dhe zhvillimit të marrëdhënieve ndërmjet grupeve të njerëzve të cilët u përkasin kulturave të ndryshme. Interkulturalizmi qartëson se kultura të ndryshme jetojnë në interaksion (Parekh, 2000). Ky interaksion nënkupton ekzistimin e interesimit reciprok, pranimit dhe respektit. Interkulturalizmi nënkupton ekzistimin e multikulturës dhe vë në pah marrëdhënien ndërmjet kulturave dhe dialog në nivele të ndryshme: lokal, regjional, nacional dhe ndërkombëtar.

QËLLIMET E ARSIMIT INTERKULTUROR

Për shkak të disa ndryshimeve bashkëkohore siç janë dyndjet masovike të njerëzve dhe përhapjes të ideve, teknologjive të reja të informimit dhe komunikimit, janë krijuar rrethana të reja të cilat individit ia vështirësojnë ritën në një personalitet të pavarur dhe të përgjegjshëm, ndërsa kjo është dhe intenca finale e të gjitha sistemeve arsimore. Në të tilla rrethana njerëzit janë të prirë t'i sforcjnë identitetet e bashkësive të bazuara në grupe etnike, kombe, fe dhe teritore, të cilat vënë në hije të drejtat themelore të individit, lirinë e ndërgjegjes, racionalitetin dhe atraktivitetin e universales (Guerrina, 2002). Dukuritë e tilla shkaktojnë tendosje në marrëdhëniet ndërmjet kombeve-shteteve-autoriteteve-teritoreve dhe aq më të mëdha janë sfidat e politikës arsimore dhe kulturore të vendeve të caktuara. Këtu nuk është qëllimi të imponohet

një kulturë e cila do të kërkonte nga pjesëtari i minoritetit apo të huajit që t'i internacionalizojë motivet themelore kulturës nacionale, por qëllimi i arsimit dhe edukimit do të duhej të jetë i orientuar drejt zhvillimit të një lloji të caktuar kosmopolitizmi që thjesht do të thotë të jesh qytetar i botës. Qëllimet e këtij kosmopolitizmi arsimor janë përpjekjet për t'u çmuar bindjet, vlerat dhe dëshirat e njerëzve të tjerë madje dhe kur ata bindje, vlera dhe dëshira janë krejt të ndryshme nga tonat dhe përpjekjet që të imagjinohet se sa ndryshe të tjerët mund të perceptojnë situata të caktuara dhe të na shohin neve.

Interkulturalizmi u paraqit si përpjekje e ekuilibrit të dallimeve ndërmjet njerëzve, bashkësive etnike, nacionale, kulturore dhe religjioze, si nxitje e dialogut, tolerancës dhe drejtësisë sociale (Bauman, 2000). Për nga origjina është menduar si një aksion dhe proces në të cilin nuk ka thjeshtë dhënie dhe marrje, në të cilin dikush do të ishte paraprakisht aktiv dhe dikush pasiv, më pak apo më shumë i rëndësishëm, por i barabartë është në marrëdhënie kurse i ndryshëm sipas përbajtjes. Të edukohen dhe arsimohen fëmijët në korniza të interkulturalizmit, ky është objektivi i sistemit të sotëm arsimor. Në fakt, një vëmendje e madhe i kushtohet pikërisht ndërgjegjësimit mbi çështje të kulturave të tjera, karakteristikave të tyre, të atyre të përbashkëta dhe të atyre që plotësisht dallohen. Megjithatë, interkultura nuk nënkupton vetëm të mësuarit e fakteve në lidhje me të tjerët por mëton drejt thellimit të mirëkuptimit reciprok, pranimit dhe bashkëpunimit të kulturave të ndryshme. Arsimi interkulturore bazohet mbi një sistem marrëdhëniesh të fëmijëve dhe të rinjve ku qëllimi është të vihen në lidhje të ndërsjellë bartësit e kulturave të ndryshme. Detyra kryesore e interkulturës në arsim është t'i bëjë të rinjtë të ndërgjegjshëm për përkatësinë e tyre nacionale por dhe tolerantë ndaj diversiteteve, gjë e cila mund të arrihet nëpërmjet zhvillimit të ndjenjës për përkatësi ndaj bashkësisë por jo vetëm ndaj saj, por dhe ndaj bashkësisë njerëzore në përgjithësi (Gutmann, 1996). Sipas kësaj, disa nga qëllimet e interkulturës do të ishin që fëmijët të mësohen se si t'i kuptojnë të tjerët, si t'i respektojnë dallimet, si të solidarizohen, të dinë të njohin dhe të refuzojnë racizëm, nacionalizëm apo çfarëdo formë tjetër të diskriminimit me çka të gjithë do të ishin të gatshëm të komunikojnë, pra t'i dëgjojnë të tjerët dhe t'i njohin për të barabartë. Nga interkultura në arsim po ashtu pritet të kontribuojë në zhvillimin e demokracisë, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, mirëkuptimin më të mirë ndërkombëtar dhe bashkëpunim, liri, siguri, paqe dhe çarmatim në botë. Po ashtu pritet të

kontribuojë dhe në promovimin e vetëdijes mbi identitetin nacional, fetar, gjuhësor dhe kulturor të individit.

PARIMET THEMELORE TË ARSIMIT INTERKULTUROR

Sipas direktivave⁴ të UNESCO-s, janë theksuar tre parime bazë të arsimit interkulturor:

Parimi i respektimit të identitetit kulturor të nxënësit

1. Arsimi interkulturor respekton identitetin kulturor të nxënësit nëpërmjet mundësisit arsimimit të përshtatshëm dhe cilësor për të gjithë.

Kjo mund të arrihet nëpërmjet:

- Shfrytëzimit të kurikulimit dhe materialit për mësim;
- Zhvillimit dhe zbatimit të metodave empirike dhe participuese të të nxënësit të cilat u përshtaten kulturave të caktuara;
- Zhvillimit dhe zbatimit të metodave të vlerësimit të cilat korrespondojnë me specifikat e kulturave të ndryshme;
- Zgjedhjes së gjuhës mësimore që përfshin gjuhën amtare të nxënësit (aty ku kjo është e mundur);
- Trajnim adekuat të mësuesve që ka për qëllim:
- T'i njohë mësuesit me traditën kulturore të vendit të tyre;
- T'i njohë mësuesit me metodën empirike, participative dhe kontekstuale të mësim;
- Të zhvillojë ndjenjën për nevojat arsimore dhe kulturore të grupeve minoritare;
- Ta mbështesë aftësinë e mësuesit që përmbajtjen mësimore, metodën e punës dhe materialin që shfrytëzon t'ua adaptojë nevojave të grupeve kulturat e të cilëve janë të ndryshme nga shumica;
- T'ua lehtësojë shfrytëzimin e diversiteteve si mjet për mësim;
- Promovimin e një mjedisi për mësim që respekton dallimet kulturore;
- Interaksion ndërmjet shkollave dhe bashkësive dhe përfshirjen e prindërve dhe komunitetit vendor në procesin mësimor;

⁴ UNESCO *Guidelines on Intercultural Education*, Education Sector, UNESCO, Paris, 2006

Parimi i ofrimit të dijeve, shkathtësive dhe qëndrimeve kulturore të gjithë nxënësve

2. Arsimi interkulturore u ofron të gjithë nxënësve dije, shkathtësi dhe qëndrime që janë të nevojshme për të qenë qytetarë aktiv dhe të përgjegjshëm në shoqëri.

Kjo mund të arrihet nëpërmjet:

■ Garantimit të kushteve të barabarta dhe të drejta në arsimim (p.sh. qasje e barabartë në arsim cilësor, eliminim të diskriminimit etj.);

■ Shfrytëzimit të kurikulimit, librave dhe materialit punës në mënyrë që:

■ T'i sigurojë dije bashkësisë kulturore shumicë mbi kulturat minoritare;

■ T'u mundësojë grupeve minoritare dije mbi shoqërinë si tërësi;

■ Të inkuadrojë sisteme të ndryshme kulturore nëpërmjet përfaqësimit të dijeve nga perspektiva të ndryshme kulturore;

■ Të shfrytëzohen metoda të përshtatshme mësimore (mësim aktive, participativ kooperativ etj.);

■ Vlerësim qartë të definuar dhe preciz të arritjeve të nxënësve (dijeve, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave);

■ Zbatim të një gjuhe të përshtatshme të të mësuarit e cila i jep mundësi çdo nxënësi të komunikojë (të shprehet) në gjuhën amtare dhe në gjuhën zyrtare të vendit si dhe në një a disa gjuhë botërore;

■ Arsimit adekuat dhe përsosje profesionale të mësuesit;

Parimi i respektit, mirëkuptimit dhe solidaritetit

3. Arsimi interkulturore u mundëson të gjithë nxënësve dije kulturore, shkathtësi dhe qëndrime të cilat i aftësojnë për të kontribuar për respekt, mirëkuptim dhe solidaritet ndërmjet individëve, grupeve etnike, sociale dhe kulturore dhe kombeve.

Kjo mund të arrihet nëpërmjet:

■ Zhvillimit të një kurikule që kontribuon në mirëkuptim dhe respektim të diversiteteve kulturore por dhe në varësinë globale ndërmjet njerëzve, zhvillimin e vetëdijes mbi të drejtat dhe obligimet, mirëkuptim për nevojën e solidaritetit dhe bashkëpunimit;

■ Zbatimit të metodave adekuate të mësimdhënies dhe të mësuarit;

■ Zhvillimit të shkathtësive të komunikimit dhe bashkëpunimit jashtë kufijve kulturor;

- Mësimi të gjuhëve të huaja dhe përparimi të komponentave kulturore të mësimi të gjuhëve;

- Arsimit adekuat të mësuesve dhe përsosje profesionale permanente e mësuesit;

Të mësuarit për jetë të përbashkët⁵ është një nga katër themelet e arsimit të shekullit 21 që është theksuar nga ana e UNESCO në vitin 1996. Arsimiti do të duhet t'u ndihmojë nxënësve të zhvillojnë dije, qëndrime dhe shkathtësi të nevojshme për jetë në një shoqëri multietnike dhe multikulturore: respektim të diversiteteve, empati, tolerancë, aftësi për komunikim, bashkëpunim dhe zgjidhje të konflikteve me rrugë paqësore, hapësi, adaptueshmëri dhe të menduar kritik (Koren, 2004).

Përfundim

Në edukimin e fëmijës bashkëpunojnë disa njerëz dhe mjedise. Kuptohet që përgjegjësinë më të madhe e kanë prindërit apo kujdestarët. Pas tyre rol të madh kanë dhe mësuesit e fëmijës që nga çerdhja deri në fakultet. Me rëndësi është të theksohet se asnjë faktor në kuadër të edukimit dhe arsimit të fëmijës, duke filluar nga prindërit, familja më e gjerë e deri te mësuesit, nuk është ekskluzivisht përgjegjës për kahjen në të cilën fëmija do të zhvillohet. Të gjithë individët në procesin e rritjes dhe maturimit të fëmijës kanë përgjegjësi të madhe e cila është e përbashkët dhe e pandashme. Të gjithë ata që janë pjesë e jetës së fëmijës dhe botës së tij patjetër të jenë të ndërgjegjshëm për rolin e tyre mjaft të rëndësishëm. Pikërisht ata të afërm pjesëmarrës direkt në procesin e zhvillimit të fëmijës do të marrin pjesë në formimin e një personaliteti. Nga ta varet në cilin drejtim ai do të zhvillohet. Prandaj, të gjithë ata mësues duhet patjetër kontribuojnë për një interkulturalitet gjeneral i cili duhet patjetër të bëhet pjesë përbërëse e jetës së fëmijës.

Conclusion

In the child's education cooperate several people and environments. It is understood that the biggest responsibility have parents or carers. Beside them great role have the child's teachers since kinder-

⁵ Komisioni ndërkombëtar i UNESCO për zhvillimin e arsimit në vitin 1996 hartoi një raport ku janë theksuar katër themelet e arsimit të shekullit 21: të mësohet për të ditur, për të bërë, për të qenë dhe për të jetuar së bashku.

garten to college. It is important to note that no factor within the education of children, ranging from parents, wider family and to the teachers, it is not exclusively responsible for the direction in which the child will develop. All individuals in the process of child's growth and maturity have a great responsibility which is the common and indivisible. All those who are part of a child's life and his world must be aware of their very important role. Precisely those relatives directly participating in the development process of the child shall participate in the formation of a personality. From them depends in which direction it will take place. Therefore, all teachers must contribute to a general interculturality that must become an integral part of the child's life.

References

- Banks, J. A. (1999) *An Introduction to Multicultural Education* (2nd ed.). Boston: Allyn & Bacon.
- Banks, J.A. (1992) 'Curriculum Guidelines for Multicultural Education', *Social Education* 55: 282.
- Bauman, Z. (1984) *Kultura i drushtvo*. Beograd: Prosveta.
- Borbély N. É. Innovative Educational Initiatives in Nagykanizsa. Достапно на: <http://lgi.osi.hu/ethnic/csdb/results.asp?idx=no&id=37>.
- Haller, I.; Ardelean, L. Multicultural Academy in Romania. LGI Case Studies Database. Достапно на: <http://lgi.osi.hu/ethnic/csdb/results.asp?idx=no&id=148>.
- Geertz, C. (1993) *The Interpretation of Cultures*. London Fontana Press.
- Guerrina, R. (2002) *EUROPE - History, Ideas and Ideologies*. London: Arnold - A member of the Hodder Headline Groupe.
- Gutmann, A. (1996) 'Challenges of Multiculturalism in Democratic Education', in R.K. Fullinwider (ed.) *Public Education in a Multicultural Society: Policy, Theory, Critique*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Parekh, B. *Rethinking multiculturalism - Cultural Diversity and Political Theory*. Massachusetts: Harvard University Press Cambridge 2000.
- Koren, S. (2004) Regionalni aspekti interkulturalizma u nastavi povijesti: pristupi, koncepti i praktična iskustva, *Povijest u nastavi*, 2, 4, 337-343.
- UNESCO *Guidelines on Intercultural Education*, Education Sector, UNESCO, Paris, 2006